REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	07.08.2019
Referencë	11-344/7
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Kopje: Kopje:	**Fauz Xhemajli-Nënkryetar i Komunës** **Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-KORRIK

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Pasqyra tabelare e punës për muajin –Korrik

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Gjobë mandatore	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore dhe të pezulluara	Inspektimi biznesev për vendosje te flamujve	Pëlqime sanitare	Mbyllje e përkohshme e lokalit	Menaxhim i tregjeve	Të hyrat nga pranimet teknike të lokaleve afariste	Aktvendime- ndalesa,urdhëresa	Biznese pa pranime teknike	Inspektime të fararërave , plehrave dhe tokave bujqësore	Kërkesa, pune me palë	Objekte të rrethuara me shirita zyrtar	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektim në ëmin e pylltarisë	Inspektime me polici	Asgjësim i mallit me afat të skaduar
Biznesit	209	39	31	2				6	6			8	450.00€	48	13		56					37.43 9.36€
Ambientit	35	18					1										12				4	
Bujqësisë	1064	455				13										56	540					
Ndërtimtarisë	27	16		1			1	3						2			3	1				
Trafikut	107	27		1		23		5				8					11				32	
Sanitar	26	23		1						2												37.43 9.36€
Gjithsejtë	1468	578	31	5		36	2	14	6	2		16	450.00€	50	13	56	622	1			36	37.43 9.36€

Gjatë muajit korrik kemi hasur në 11 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit te biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pran qëndresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan.

Gjithashtu kemi pasur 13 biznese pa pranime teknik te lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjenike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek inspektoret e tregut.

Janë asgjësuar mall të llojit kozmetik me afat të skaduar dhe të dëmtuar me kërkesën biznesit në vlerë prej 37,439.36 €.

Kemi pasur në një ankesë të konsumatorit, të cilit biznesi nuk i ka ofruar kupon fiskal për shërbimin e ofruar në një restorant i cili veprim është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit ndaj të cilit janë marr masat ligjore.

Gjatë muajit është bërë inspektimi i disa subjekteve afariste në veçanti i kemi inspektuar të gjitha pishinat në tërë territorin e Komunës tonë. Gjendja higjenike-sanitare e pishinave është në nivelin optimal. Të gjitha Pishinat kanë kontart me IKSHPK (për marrjen e mostrave dhe analizave të ujit).

Janë inspektuar sallat e dasmave dhe disa restorante e kafiteri, të gjitha janë inspektuar në aspektin higjieno-sanitar dhe për të gjitha vërejtjet i është dhënë urdhër me procesverbal për eliminimin e tyre.

Kemi vazhduar edhe në këtë muaj inspektimin dhe kontrollimin në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari “ në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare të Aeroportit dhe policin njësia në Magure për auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, për ata të cilët i kemi takuar me procedurë të përshpejtuar i kemi dërguar në Gjykatë dhe i është shqiptuar masa ndëshkimore sipas ligjit për transportin rrugor.

Është bërë inspektimi i firmave/bizneseve të autobusëve në relacione të ndryshme që operojnë në territorin e Lipjanit se mos ka ndonjë vonës në rende të udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taskive që janë të parkuar ne parkingjet në qytet dhe janë bërë disa pika kontrolli në bashkëpunim me policin e Kosovës në disa rrugë ku qarkullojnë auto-taksit se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtarin pa u pajisur me licencë.

Janë kontrolluar edhe firmat ndërtimore në lidhje me trotuaret se mos po i bëjnë dëmtimin e tyre për ata të cilët i kemi hasur të pa pajisur me pëlqim nga DSHP-ja ju kemi dhënë vërejtje që të pajiseni me pëlqim ose për ndryshe nuk munden ta shfrytëzojnë pjesën e trotuarit para objektit të ndërtimit për hyrje-dalje ose vendosjen e materialit ndërtimor.

Është dalë në teren në fsh Sllovi dhe Turboc sipas ankesave të qytetarëve në lidhje me ndotjet të ajrit që janë duke bërë kamionët gjatë qarkullimt në ndërtimit të autostradës për Gjilan. Të gjitha firmave të cilët operojnë janë urdhëruar që të shtojnë intensitetin e ujitjes së rrugëve që mos të ketë ngritje të pluhurit në ajër.

Kemi bërë kontrollimin në objektet shumëkatëshe të cilat janë në ndërtim e sipër, si dhe bizneset se a janë duke zbatuar Lejet Mjedisore Komunale. Investitorëve u është dhënë urdhëresa që mbeturinat në vende punishte të grumbullohen dhe të vendosen në kontejner të caktuar.

Janë takuar biznese dhe persona fizik duke hedhur mbeturina jashtë vendeve të caktuara, ndaj tyre janë marrë masa ligjore.

Është kujdestaru në mbrëmje, për ti larguar shitësit ambolantiv nga Sheshi “Adem Jashari”. Një kujdestari e tillë është në vazhdimësi edhe në muajit tjetër deri sa të jenë bashkatdhetarët tan me qëllim që Sheshi të jetë i lirë nga shitësit anbullant të cilët ja kishin humbur edhe pamjen Sheshit

Kemi inspektuar markete ushqimore për produktet ushqimore me prejardhje bimore. Janë inspektuar pyjet dhe shitësit ilegal të tyre në tregje dhe pjesë të tjera .

Janë inspektuar tokat bujqësore ku i'u është ndërruar destinimi, atyre që janë mbushur me materiale të ndryshme si dhe tokat që janë dëmtuar nga faktorët klimatik dhe ndikimi i faktorit njeri si dhe janë ndërpre punishte ku ka filluar ndërtimi e nuk posedonin ndërrim-destinimi të tokës bujqësore po ashtu janë ndërprerë disa mbushje të parcelave.

Janë kryer kontrolla në teren për aplikuesit e serrave, kultivatoreve me OJQ- Qatar Qarity

Inspektori i ndërtimtarisë ka inspektuar objekte të shumta dhe të ndryshme ndërtimi dhe janë identifikuar (2) objekte-shtëpi banimi pa leje ndërtimi dhe një (1) Autolarje duke përfshirë edhe një (1) Lift nga konstruksioni metalik ndaj të cilave janë ndërmarrë masa ligjore sipas ligjit të ndërtimit. Inspektimet tjera rezultojnë të pajisura me Leje ndërtimi nga organi kompetent. Gjendja e ndërtimit në terren është në suaza të normales, me një rënje graduale nga temperaturat e larta, pushimeve verore por nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues nga Inspektori i ndërtimtarisë.